


Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës
Seksioni i Arteve



EKSPOZITË
&
MBRËMJE MUZIKORE-POETIKE
80-vjetori i lindjes së
muzikologut Engjëll Berisha dhe piktorit Xhevdet Xhafa



Marrin pjesë:

Çun Lajqi, aktor
Sanije Matoshi, mexosoprano
Lirika Pula Kasapolli, piano

Të premten, më 5 dhjetor 2014, në orën 18:00,
në Ambientet e Akademisë së Shkencave
dhe të Arteve të Kosovës.

EKSPOZITË & MBRËMJE MUZIKORE-POETIKE

Programi:

- Haki Taha (1908-'45)
Kosovë, o shpirti i jonë (1943)
- Rauf Dhomi (*1945)
Vajta, kalova (përpunim, 1984)
- Frrok Kristaj (*1944)
I gjallëron heshtjet (1973)
- Simon Gjoni (1926-'91)
Lule bore (1949)
- Zequirja Ballata (*1943)
Përrurim (1994)
- Prenk Jakova (1917-'69)
Margjelo (1960)
- Ali Podrimja (1942-2012)
Baladë për njeriun e vogël (dekada e fundit)
- Georges Bizet (1838-'75)
Habanera nga opera "Carmen" (1873-'74)

Akademik Engjëll Berisha (*1934) dhe anëtari korrespondent Xhevdet Xhafa (*1934), këtë vit festojnë 80-vjetorin e lindjes, por njëherit edhe të veprimtarisë së tyre krijuese-artistike, pedagogjike dhe shkrimore përgjatë një vargu dekadash të kaluara.

Seksioni i Arteve i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, prandaj, me këtë rast të jubileut jetësor dhe krijues të këtyre dy kolegëve tanë po e realizon sot një Ekspozitë autoriale përzgjedhëse të piktorit tonë të njohur Xhevdet Xhafa (fjala e rastit: akad. Rexhep Ferri).

Njëherit, në vijim, pason dhe Mbrëmja muzikore-poetike. Në të janë përzgjedhur katër këngë për zë e piano kompozitorësh tanë (Prenk Jakova, Simon Gjoni, Rauf Dhomi) dhe botërorë (Georges Bizet), përmbajtjesh kryesisht lirike, por dhe me asosh dramatike e mallëngjyese. Që të gjitha janë t'afërta, lehtësisht të kapshme, të kuptueshme e të njohura, të interpretuara me sukses gjithandej viseve tona mbarëkombëtare dhe më gjerë. E, mes këtyre ndërthuren dhe katër poezi autorësh tanë periudhash të ndryshme dhe të bujshme kohore: Haki Taha: *Kosovë o shpirti i jonë*; Ali Podrimja: *Balada për njeriun e vogël*; Frrok Kristaj: *I gjallëron heshtjet*; Zequirja Ballata: *Përrurim*. Dhe, pikërisht jubilentit Engjëll Berisha (fjala e rastit akad. Zequirja Ballata), i kushtohen dy poezitë e fundit.

Akademik Zequirja Ballata